

VENDIM
Nr. 808, datë 26.12.2018

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 490, DATË 31.7.2018, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË, PËR PAGESËN E
SHËRBIMEVE JURIDIKE PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN
NË GJYKATËN ITALIANE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 13, të ligjit nr. 190/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, dhe të neneve 4, pika 7, 5, pika 1, shkronja “b”, 12, pikat 2 e 6, 15, pika 8 dhe 18, pika 2, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 1, të vendimit nr. 490, datë 31.7.2018, të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 1.1 dhe 1.2, me këtë përmbajtje:

“1.1. Autorizimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që nëpërmjet Avokaturës së Shtetit të lidhë shtesë kontrate me firmën avokatore italiane për përfaqësimin e interesave të shtetit shqiptar në çështjen “Iliria SRL”, zhvilluar në gjykatat italiane, të iniciuar nga shoqëria “Iliria SRL”, në vlerën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

1.2. Shtesa e kontratës të rregullojë përfaqësimin e interesave të shtetit shqiptar, për të gjitha proceset gjyqësore në gjykatat italiane, që rrjedhin nga çështja e “Iliria SRL”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama